



Organizata Jo-Qeveritare: Advancing Together

Rexhep Mala 27/A,
10000, Prishtinë

19 Prill 2020

I nderuari zot. Mytarer Haskuka- Kryetar i Komunës së Prizrenit,

I nderuari zot. Burim Berisha- Kryetar i Komunës së Fushë Kosovës,

Uroj të jeni mirë me shëndet dhe dëshiroj të ju përzëzohem për punën e suksesshme që keni bërë deri tash. Suksesi juaj si komuna në kohën kur Kosova dhe e gjithë bota janë duke u përballur me parandalimin e pandemisë COVID-19, e cila çdo ditë e më shumë po prek qytetarët tanë, e shoh si të arsyeshme të i kini në konsideratë të drejtat elementare të cilat janë të mbrojtura me Kushtetutë dhe ligjet e Republikës së Kosovës, që personave të identifikuar pozitiv me COVID-19 tu ruhet e drejta e privatësisë dhe mos-diskriminimit racor apo etnik.

Duke ju referuar konferencës për shtyp të mbajtur nga Shtabi Emergjent i Komunës e i udhëhequr nga ju dhe Drejtori i Shëndetësisë (të datës 15 Prill 2020), të transmetuar nga RTV Besa dhe publikuar në portalin e Komunës së Prizrenit si dhe intervistës se publikuar nga TV Prizreni me Drejtorin e Qendrës Rajonale të Shëndetësisë Publike në Prizren, si dhe gjatë deklaratimeve publike të zyrtarve të Komunës së Fushë Kosovës (të datës 19 Prill 2020) kur është bërë publik përkatësia etnike e dy personave të identifikuar si pozitiv me COVID-19.

Duke marrë parasysh praktikën e deritanishme të Institutit të Shëndetësisë Publike të Kosovës dhe Ministrisë së Shëndetësisë, të cilët deri më sot nuk kanë bërë asnjëherë publikimin e të dhënave personale dhe të ndjeshme të personave të identifikuar si pozitiv me COVID-19, konsideroj që bërja publike e përkatësisë etnike të rasteve të testuar pozitiv me COVID-19 në Komunitet tuaja përbën shkelje ligjore dhe diskriminon pakicat e Republikës së Kosovës.

Duke ju referuar **Kushtetutës së Kosovës, Neni 36** garanton që të gjithë qytetarët e Kosovës gëzojnë të drejtën e privatësisë. Për më tepër, **ligji Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Neni 3, Pika 1.25** siguron që të gjitha *“të dhënat personale të ndjeshme që zbulojnë origjinën etnike ose racore, pikëpamjet politike ose filozofike, përkatësinë fetare, anëtarësimin në sindikatë ose çdo e dhënë për gjendjen shëndetësore ose jetën seksuale”* janë të mbrojtura me ligje dhe nuk mund të behen publike. **Ligji Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre**

Faqe 1 prej 2

në Republikën e Kosovës në Nenin 3, pika 3.3: 3.3. thotë që *“Ndalon të gjitha format e diskriminimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në bazë të identitetit kombëtar, etnik, kulturor, gjuhësor apo fetar”*.

Vlen të përmendet që në rastin e Komunës së Prizrenit dhe Komunave të tjera të Kosovës, edhe para dhe pas 15 Prillit 2020, ka raste të pakicave tjera të cilët janë testuar pozitiv me COVID-19 dhe që deri tash, nuk iu është publikuar përkatësia etnike, e më të u paraqitur 2 rastet e para që janë pjesëtare të komunitetit Rom- bëhet publik identiti i tyre etnik!

Të dyja rastet janë raste kontakti (nenë e bijë) të cilët janë duke u trajtuar me kujdesin e shembullor- njëri rast në Klinikën infektive të QKUK-së, ndersa rasti i dytë është në vetizolim në Fushë Kosovë.

Për këtë arsye, ju ftoj juve dhe të gjitha organet tjera kompetente komunale dhe qendrore të merrni për bazë ligjet në fuqi dhe të siguroni privatësinë e çdokujt të prekur nga COVID-19.

Apeloj dhe uroj që një gjë e tillë të mos përsëritet në të ardhmen në asnjë komunë pasi që kjo mund të ndikoj negativisht në marrëdhënjet ndër-etnike në Kosovë. Për më tepër, një gjë e tillë mund të nxisë stigmatizimin ndaj të të prekurve, familjeve të tyre, si dhe cenojë dhe thellojë diskriminimin ndaj komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, sidomos ndaj atyre që jetojnë në kushte të rënduara sociale dhe në varfëri të skajshme, të papunë apo të varur prej ekonomisë jo-formale dhe punëve ditore!

Informimi i drejtë dhe i kujdesshëm në këto raste duhet të jetë shembullor duke i mos i lënë hapësirë as politikanëve dashakeq dhe të paskurpullt që dëshirojnë të përfitojnë nga ndarësitë e as mediave të kontribuojnë në ndarësi mes qytetarëve të Kosovës.

Në fund fare, uroj që kjo kohë e pandemisë të kalojë sa më herët të jetë e mundur dhe me sa më pak pasoja në jetëra gjatë kësaj beteje kundër një armiku që nuk bënë dallime.

Me respekt,

Bashkim Ibishi
Drejtor Ekzekutiv

Kopje: Arben Vitia- Minister në Detyrë i Ministrisë së Shëndetësisë;

Emilia Redžepi- Ministreshë në Detyrë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal;

Albin Kurti- Kryeministër në Detyrë i Qeverisë së Republikës së Kosovës

Agim Veliu, Kryetar i Bordit të Asociacionit të Komunave të Kosovës

Xhafer Gashi, Nënkyetar i Asociacionit të Komunave të Kosovës

Sazan Ibrahim, Shef Ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës

Gentiana Begolli- Pustina, Kryetare e Bordit të Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës